



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.903/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Elfete Vitia, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Elfete Vitia, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë me shenjën ZL.Anr.903/2017 e datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017, ka pranuar një apel nga Elfete Vitia, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, e cila ka pretenduar se i mungojnë votat e të afërmeve të saj dhe nuk është e kënaqur me rezultatin përfundimtar, i mungojnë votat në shkollën “Shkëndija”, “Asim Vokshi”, “Zenel Hajdini”, “Hasan Prishtina” dhe kërkon nga PZAP-i të bëhet rinumërimi i kutive për arsye se në fletëvotime i ka pas 41 vota, ndërsa nga rezultati përfundimtar të KQZ-së i ka 22 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel të parashtrueses së apelit janë të pabazuara pasi që nuk ka ofruar asnjë dëshmi bindëse lidhur me pretendimet e parashtruara në apel.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apellesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë të bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.903/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesja e Panelit
Gylfene Syeljmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*